



Pranuar / Doretuar Priljenoi/Prodato Received/Delivety	31.07.2023	Vite Gjati Vjeçr	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bi Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSTOCK	5463/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.847/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti -anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 847/2023, të datës 15.06.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë

Kosovës kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës në çështjen juridike " masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.847/2023 e datës 15.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në atë mënyrë që aprovohet si i bazuar pretendimi lidhur me Vendimin Ref:KE-332/2023 të datës 09.06.2023 të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa refuzohet pretendimi ankimor lidhur me Vendimin me numër DQIPGJ 158/23 të datës 26.05.2023 të Udhëheqësit të Sektorit për Inspektim në Pylltari.

II. Shfuqizohet Vendimi për ndalesë në pagë, me numër Ref:KE-332/2023 i datës 09.06.2023 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, mbetet në fuqi Vendimi DQIPGJ 158/23 i datës 26.05.2023 i Udhëheqësit të Sektorit për Inspektim në Pylltari lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje me shkrim" ndaj ankuesit

III. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ankueses ti kompensoj shumën në vlerë prej 4.68 euro, të ndaluar në pagë sipas Vendimit me numër Ref: KE-332/2023 të datës 09.06.2023.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje ankuesi) i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, më datë 15.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kundër Vendimit DQIPGJ 158/23 të datës 26.05.2023 të Udhëheqësit të Sektorit të Inspektimit në Pylltari, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje me shkrim" si dhe Vendimit me numër Ref:KE-332/2023 të datës 09.06.2023 të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës për ndalesë në pagë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave ligjore, shkeljeve të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe shkeljeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 22.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 847/2023, e datës 15.06.2023, me numër protokoll 4747/2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; evidencat e vijueshmërisë në punë për datën 22.05.2023; e-mail i datës 22.05.2023; Vendim me numër 4310, i datës 06.09.2023; e-maili i datës 24.05.2023; Vërejte me shkrim me numër protokoll 158/2023, e datës 26.05.2023; Akt Emërimi me numër protokoll ZPD, i datës 26.04.2013; E-maili i datës 12.01.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 847/2023, i datës 22.06.2023;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë së ankuesi është e punësuar në Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, gjegjësisht e njëjti sipas Aktit të Emërimit ZPD: 130/2013 të datës 26.04.2013 ushtron pozitën e punës me titull "Inspektor i Pylltarisë", në Sektorin Drejtoria e Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë.

Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim në Pylltari me Vendimin DQIPGJ -158/23 të datës 26.05.2023, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "vërejtje me shkrim", me arsyetimin se i njëjti me datë 22.05.2023 është nënshkruar në formularin e evidencës së ardhjes në punë në ora tetë (8) e që në fakt deri në ora tetë e dyzetepesë (8:45) minuta ka qenë në restorantin "Mamas" pa leje nga Udhëheqësi i drejtpërdrejt, përkundër se për një gjë të tillë iu ishte tërhequr vërejtja përmes e-mailit zyrtar të datës 12.01.2023 nga Drejtori i Drejtoratit Qendror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti duke i paralajmëruar se kjo është vërejtja e fundit e cila ju tërhiqet dhe nuk ndërmerren masa disiplinore.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se Drejtori Ekzekutiv i APK-së bazuar në kërkesën e Drejtorit të DQIPGJ të datës 25.06.2023 ka nxjerrë Vendimin Ref. Ke-332/2023 të datës 09.06.2023 për ndalesë

në pagë për ankuesin në vlerën prej 4.68 euro për shkak të mungesës së një orë pune në muajin maj 2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se masa disiplinore "vërejtje me shkrim" është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ka shqiptuar vërejtje me shkrim kinse për mosrespektimin e orarit të punës nga ora 08:00 -08:45, ndërsa i njëjti nuk ishte prezent gjatë kësaj kohë. Me tej thekson së ndalesa e pagës sipas Vendimit Ref. Ke-332/2023 të datës 09.06.2023, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenin 45 më të cilin përcaktohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore dergjët veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", dhe si rrjedhojë ka konstatuar së nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht edhe organi kompetent publik me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil është i obliguar që të veproj në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mos diskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshëm dhe të arsyeshme, si dhe parimin e informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenin 4, 5, 6, 7, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Duke marrë përsysh natyrën e shkeljes disiplinore, Kolegji iu referua edhe Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, përkatësisht nenit 9 më të cilin është përcaktuar: *Respektimi i orarit të punës 1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mos regjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mos prezencë në punë. 4. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore. 6. Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.*

Në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, e duke u bazuar në analizimin e provave materiale, Kolegji ka konstatuar së ankuesi përkundër se me emailin zyrtar të datës 21.01.2023 të Drejtorit të DQIPGJ-së, ishte paralajmëruar për mos respektim të orarit të punës, e njëjta më datë 22.05.2023 ishte nënshkruar në evidencën e ardhjes në punë në ora 7:50, mirëpo ankuesi nuk kishte qenë prezent në vendin e punës deri në ora 8:45 dhe së për këtë mos prezencë nuk kishte leje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, kështu që në vlerësimin e Kolegjit ankuesja me këto veprime ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 9 të Rregullores(QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, andaj, pretendimi ankimor lidhur me kundërligjshmërinë e vendimit për shqiptimin masës disiplinore "vërejtje me shkrim" është i pa bazuar. Rrjedhimisht, Udhëheqësi i Sektorit Për Inspektim në Pyltari në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses

si shkelje të lehtë disiplinore dhe drejtë ka zbatuar ligjin material me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të atakuar me ankesë.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor përkitazi me kundërligjshmërinë e Vendimit për ndalesë në pagë me numër Ref:KE-332/2023 i datës 09.06.2023 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, Kolegji konstaton së ndaj nëpunësit civil në rast të konstatimit të përgjegjësie disiplinore mund të shqiptohen vetëm masat disiplinore siç përcaktohet me nenin 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku thuhet se: *Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil.* Rrjedhimisht mbi këtë përcaktim ligjor dhe duke iu referuar nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton se për shkelje të lehta disiplinore kompetent është udhëheqësi i nëpunësit civil dhe masa e vetme disiplinore që mund të shqiptohet për shkelje të tilla është masa disiplinore "vërejtje", andaj mbi këtë bazë rrjedhë së ndalesa në pagë për ankuesen sipas Vendimit Ref: KE-329/2023 të datës 09.06.2023 të Drejtorit Ekzekutiv të APK-së nuk është veprim i lejuar me dispozita materiale në fuqi dhe nuk është i kualifikuar si masë disiplinore, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë është ligjërisht i drejtë.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicini i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda A. nr. 847/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës.
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit